

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7913
E enjte, 24 tetor 2024
Çmimi 0.50 €

Kurti: Kosova do të blejë objekte për ambasada në pesë shtete kyçe | **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KE-ja MIRATON AGJENDAT E REFORMAVE TË KOSOVËS DHE KATËR SHTETEVE TË TJERA TË RAJONIT | **FAQE 3**

Komisioni Evropian e ka bërë hapin kyç për t'i mundësuar pagesat e para për vendet e Ballkanit Perëndimor nga Plani i Rritjes dhe reformave, duke miratuar në takimin e 23 tetorit agjendat e reformave për Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Krahasuar për kokë banori, Kosova do të jetë përfituesja më e madhe nga Plani i Rritjes, pasi shteti do të përfitojë më shumë se 820 milionë euro



INTERVISTË ME ZOGE SHALËN, ANËTARE E GRUPIT TË TË RINJVE TË PEJËS TË PAJTIMIT TË GJAEVE NË KOSOVË 1990-1991

PAJTIMI I GJAEVE ISHTE ME RËNDËSI JETIKE PËR LUFTËN ÇLIRIMTARE NË KOSOVË | **F. 3**



SLLOVAKIA DO TA MBYLLË ZYRËN NDËRLIDHËSE NË KOSOVË | **F. 7**

BLINKENI THOTË SE "TANI ËSHTË KOHA" PËR T'I DHËNË FUND LUFTËS NË GAZË | **F. 5**

AKTUALE

TOLLOVIA NË MERDAR U KUSHTON BIZNESEVE | **F. 8**

NJË PRONË E APK-së, AFËR OBJEKTIT TË QEVERISË, I KTHEHET MINISTRISË SË BUJQËSISË | **F. 8**

EKONOMI

SPORT



SERMAXHAJ: DUA TA NXJERR MË TË MIRËN NGA VAJZAT E KOSOVËS | **F. 10**

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Blinkeni thotë se “tani është koha” për t’i dhënë fund luftës në Gazë

WASHINGTON, 23 TETOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, u ka bërë thirrje të mërkurën Izraelit dhe grupeve të mbështetura nga Irani, kundër të cilave po lufton në Gazë dhe Liban, për të arritur armëpushim, pasi ushtria izraelite tha se e vrau një zyrtar të lartë të Hezbollahut. Zyrtari i vrarë thuhet se do të emërohej lider i ri i Hezbollahut, grupit militant dhe partisë politike që kontrollon jugun e Libanit. “Tani është koha t’i shndërrojmë këto suksese në një sukses strategjik afatgjatë”, tha Blinkeni për gazetarë në Jordani të mërkurën, pak para nisjes për në Arabinë Saudite.

Blinkeni është në një turne në rajon për bisedime për të gjetur një mënyrë për t’i dhënë fund luftës.

Të martën mbrëma Izraeli tha se Hashem Sfieddine, figurë e lartë brenda Hezbollahut, u vra në një sulm ajror në kryeqytetin libanez më 3 tetor, duke u dhënë fund thashethemeve disajavore se a ishte gjallë apo jo njeriu që pritej ta merrte drejtimin e grupit.

Lideri i kaluar i Hezbollahut, Hassan Nasrallah, u vra në një sulm ajror në Bejrut më 27 shtator.



Safieddine e drejtonte degën ekzekutive të Hezbollahut, e cila mbikëqyr çështjet politike të grupit. Ai ishte, gjithashtu, anëtar i Këshillit vendimmarrës Shura, si dhe i Këshillit të Xihadit, i cili drejton operacionet ushtarake të grupit.

Shtetet e Bashkuara e shpallën Safieddine terrorist në vitin 2017.

Hezbollahu, i cili e kontrollon Libanin jugor, është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian e ka vendosur në listën e

zezë krahun e tij të armatosur, por jo edhe partinë e tij politike.

Lufta e tanishme midis Izraelit dhe grupeve të mbështetura nga Irani, Hezbollah dhe Hamas, i cili është i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian - u nxit pasi Hamasi e kreu një sulm befasues në Izrael më 7 tetor 2023, duke i vrarë rreth 1 200 persona, si dhe duke i rrëmbyer rreth 240 të tjerë.

Prej atëherë Izraeli është duke e kryer një luftë të ashpër në Gazë, e cila, sipas Ministrisë së

Shëndetësisë së drejtuar nga Hamasi, i ka vrarë pothuajse 43 000 njerëz, ndërsa ka zhvendosur pothuajse të gjithë popullsinë prej 2.3 milionë banorësh të Gazës.

Forcat izraelite kanë vrarë shumë figura të larta të Hezbollahut dhe Hamasit, përfshirë liderin e grupit militant palestinez, Yahya Sinwar, i cili dyshohej se ishte arkitekti i sulmit të 7 tetorit.

Sinwar u vra javën e kaluar nga Forcat Mbrotjëse të Izraelit, duke nxitur zyrtarë të lartë nga Shtetet e Bashkuara dhe aleatë të tjerë

izraelitë ta shohin këtë si një mundësi për një skenar të ri për rajonin.

Izraeli është përballur njëkohësisht me trysni nga shumë aleatë, përfshirë Shtetet e Bashkuara, për numrin në rritje të viktimave civile në Gazë si rezultat i luftës dhe me akuza se ka penguar furnizimet me ndihma për këtë territor, ku qindra mijëra njerëz po jetojnë në një krizë humanitare gjithnjë në rritje. “Përqendrimi duhet të jetë te kthimi i pengjeve, përfundimi i kësaj lufte dhe një plan i qartë për atë që vjen më pas”, tha Blinken më 23 tetor.

Asnjëra palë, megjithatë, nuk duket e gatshme, të paktën publikisht, të shfrytëzojë atë që Blinken dhe të tjerët e shohin si mundësi.

Vetëm disa orë para se të fliste Blinken, ushtria izraelite rrëzoi një ndërtesë në një periferi të Bejrutit që tha se strehonte objekte të Hezbollahut. Në fundjavë Qeveria izraelite tha se shtëpia e kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu u dëmtua nga një sulm me dron.

Ndërkohë, Hamasi vazhdon të mos pranojë t’i lirojë pengjet e mbetura që mban, pa e ndaluar Izraeli luftën në Gazë.

Jep dorëheqje prokurori i Përgjithshëm i Ukrainës pas hetimeve për korrupsion

KIEV, 23 TETOR - Prokurori i Përgjithshëm i Ukrainës, Andriy Kostin, ka dhënë dorëheqje mes hetimeve që gjetën se dhjetëra zyrtarë qeveritarë kishin shmangur shërbimin ushtarak, duke kërkuar që të marrin përfitime për aftësi të kufizuara.

Mobilizimi është një çështje shumë e ndjeshme në Ukrainë, pasi numri i ushtarëve të këtij shteti është varfëruar, teksa lufta e nisur nga Rusia kundër Ukrainës po vazhdon që dy vjet e gjysmë. Kostin njoftoi për dorëheqjen e tij

më 22 tetor përmes Telegramit, pas një takimi të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të Ukrainës, ku mori pjesë presidenti Volodymyr Zelensky, i cili tha se Kostin “duhet të marrë përgjegjësi” për situatën e krijuar. “Mendoj se qëndrimi i presidentit Zelensky është absolutisht i drejtë... dhe po ashtu mendoj se është korrekte që të njoftoj për dorëheqjen time si prokuror i Përgjithshëm”, tha Kostin përmes Telegramit.

Më herët gjatë këtij muaji, hetuesit gjetën se një numër i prokurorëve

publikë në rajonin perëndimor të Kmelintskit jashtëligjshëm kishin marrë dokumente për të dëshmuar në mënyrë të rreme se kishin aftësi të kufizuara, në mënyrë që të merrnin përfitime nga shteti.

Pak pas dorëheqjes së Kostinit, kryeministri Denis Shmyhal, njoftoi për shkarkimin e disa zyrtarëve të lartë që mbikëqyrin shërbimet, dhe zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë që koordinojnë aktivitetet me komisionet lokale.



DASH pas arrestimit të Metës: Mbështesim përpjekjet e SPAK-ut në luftën kundër korrupsionit



TIRANË, 23 TETOR - Departamenti Amerikan i Shtetit tha se Washingtoni mbështet përpjekjet e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit në Shqipëri (SPAK). Kështu tha një zëdhënës i DASH-it për “Zërin e Amerikës” në kërkesën për ta komentuar arrestimin e ish-presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta. “Jemi në dijeni të arrestimit. Ju referojmë tek autoritetet shqiptare për detaje të mëtejshme në lidhje me rastin. Shtetet e Bashkuara mbështesin përparimin e Shqipërisë drejt sundimit të ligjit,

përfshirë përpjekjet e SPAK-ut për të ndjekur penalisht korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimin e organizuar, në përputhje me ligjin”, tha zëdhënësi i DASH-it.

Meta, që udhëheq Partinë e Lirisë, u arrestua më 21 tetor me urdhër të SPAK-ut. Ai dyshohet për korrupsion, pastrim parash dhe fshehje të pasurisë. Partia e Lirisë dhe subjekti tjetër opozitar, Partia Demokratike, e kanë cilësuar si politik arrestimin e Metës.

Meta ka mbajtur disa pozicione

të rëndësishme në hierarkinë shtetërore si president, kryetar Kuvendi, kryeministër, ministër i Jashtëm dhe ministër i Ekonomisë.

Arrestimi i tij nxiti reagime të mëdha në Shqipëri, pasi partia e tij tha se ai u arrestua me forcë.

Policia dhe ministri i Brendshëm shqiptar, Ervin Hoxha, arsyetuan përdorimin e forcës gjatë arrestimit të Metës, pasi thanë se ish-presidenti kishte refuzuar të dilte nga makina me të cilën po udhëtonte dhe kishte ofenduar zyrtarë policorë.

KE-ja miraton agjendat e reformave të Kosovës dhe katër shteteve të tjera të rajonit

Komisioni Evropian e ka bërë hapin kyç për t'i mundësuar pagesat e para për vendet e Ballkanit Perëndimor nga Plani i Rritjes dhe reformave, duke miratuar në takimin e 23 tetorit agjendat e reformave për Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Krahasuar për kokë banori, Kosova do të jetë përfituesja më e madhe nga Plani i Rritjes, pasi shteti do të përfitojë më shumë se 820 milionë euro



PRISHTINE, 23 TETOR - Komisioni Evropian e ka bërë hapin kyç për t'i mundësuar pagesat e para për vendet e Ballkanit Perëndimor nga Plani i Rritjes dhe reformave, duke miratuar në takimin e 23 tetorit agjendat e reformave për Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Komisioni Evropian tha se e mori këtë vendim pasi shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë dhënë pëlqimin e tyre për këto agjenda. Bosnjë-Hercegovina ka mbetur vendi i vetëm për të cilin agjenda e reformave nuk është miratuar ende. Ky shtet ishte i vetmi që nuk dorëzoi me kohë agjendën e reformave. "Në planet e tyre

ambicioze të reformave, pesë qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor shprehin përkushtimin për reformat fundamentale dhe socio-ekonomike të cilat do t'i ndërmarrin për të siguruar rritje dhe konvergencë me BE-në në kuadër të Planit të Rritjes gjatë periudhës prej vitit 2024 deri më 2017", u tha në njoftimin e BE-së. Plani i Rritjes është në vlerë të përgjithshme prej 6 miliardë eurosh, nga të cilat 2 miliardë do të jenë para pa kthim, ndërsa pjesa tjetër do të jetë në formë të kredive të favorshme. Krahasuar për kokë banori, Kosova do të jetë përfituesja më e madhe nga kjo paketë, pasi shteti do të përfitojë më shumë se 820

milionë euro. Miratimi i agjendave të reformave është përshëndetur edhe nga presidentja e KE-së, Ursula von der Leyen. "Jam e impresionuar me punën që kanë bërë partnerët tanë në Ballkanin Perëndimor në agjendat e tyre të reformave. Kjo dëshmon se ata janë të

përkushtuar që të ketë sukses Plani i Rritjes. Ky është një udhërrëfyes i ynë për të afuar pranë nesh ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe për t'u mundësuar ndërmarrjeve të tyre qasjen dhe mjetet për të konkurruar në tregun tonë unik. Secili përfiton dhe është një hap i

madh drejt BE-së", ka deklaruar von der Leyen. Agjendat e reformave përqendrohen në fushat me prioritet si sundimi i ligjit, të drejtat themelore, qeverisja, tranzicioni digital dhe i gjelbër, kapitali njerëzor dhe zhvillimi i një mjedisi biznesor.

Haradinaj takon Kasanofin në ShBA, flasin për pranimin e Kosovës në NATO

WASHINGTON, 23 TETOR - Kryetari i subjektit opozitar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, është takuar me të dërguarin amerikan për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kasanof, në Uashington të Shteteve të Bashkuara.

Haradinaj tha se angazhimi i udhëheqjes amerikane është i domosdoshëm që të arrihet një marrëveshje strategjike mes dy shteteve, duke shtuar se ky angazhim është i domosdoshëm edhe sa i përket përparimit të Kosovës drejt integritit euroatlantik, përfshirë në NATO. "Në këtë takim, theksa nevojën për një kontratë afatgjatë që për synim ka anëtarësimin e përshpejtuar të Kosovës në NATO, pasi ky është një hap jetik për



garantimin e sigurisë dhe paqes së qëndrueshme në rajon", shkroi Haradinaj në "Facebook". Kosova ka vendosur si synime të saj strategjike anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe NATO. Në

fund të vitit 2022 Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE, por aplikimi i Prishtinës ka ngecur në sirtarët e bllokut evropian. Ndërkaq, sa i përket NATO-s, aleancës ushtarake e cila ka mision

paqeruajtës në Kosovë, Prishtina fillimisht kërkon që të bëhet pjesë e Partneritetit për Paqe, e më pas një anëtarësim të plotë në këtë aleancë.

Haradinaj tha se të gjitha arritjet e Kosovës që nga vitet '90 dhe procesi i shtetndërtimit janë bërë në partneritet të ngushtë me ShBA-në. "Edhe anëtarësimi i Kosovës në NATO duhet të jetë një fitore e përbashkët", shkroi Haradinaj në "Facebook".

Ndryshe, Kasanof në fillim të tetorit vizitoi Kosovën dhe Serbinë. Ai tha se veprimet e pakoordinuara të Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga Albin Kurti, komplikojnë kapacitetet e SHBA-së për të mbështetur Kosovën. "Në takimet e mia me presidenten dhe kryeministrin kam përsëritur

dëshirën tonë për një partneritet më efektiv", tha Kasanof gjatë një takimi me gazetarë në Prishtinë më 11 tetor.

Kosova është kritikuar nga ShBA-ja, por edhe Bashkimi Evropian, për disa hapa të ndërmarra nga Qeveria që kanë ndikim në komunitetin serb, sikurse heqja nga përdorimi për pagesa me para të gatshme i dinarit serb, shpronësimi në veri të Kosovës për ndërtimin e bazave policore, mbyllja e institucioneve paralele, që funksionojnë sipas sistemit serb, e tjera.

ShBA-ja disa herë i ka cilësuar këto veprime si "të pakoordinuara" dhe "të njëanshme", duke paralajmëruar Kurtin se veprime të tilla mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e partneritetit mes dy vendeve.

Kurti: Kosova do të blejë objekte për ambasada në pesë shtete kyçe

PRISHTINE, 23 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se shteti do të blejë objekte të ambasadave në pesë shtete të ndryshme të botës. Gjatë mbledhjes së Qeverisë së Kosovës, Kurti tha se ka nisur procesi i blerjes së objekteve të ambasadave të Kosovës në Itali, Turqi, Francë, Gjermani dhe Kanada. "Dje përoruam objektin e ri të Konsullatës tonë në Strasburg, që tashmë është pronë e shtetit dhe shtëpi e

përhershme e Republikë sonë", tha Kurti. "Pra, po vazhdojmë blerjen e objekteve të ambasadave tona në shtetet kyçe për shërbimin tonë diplomatik", shtoi ai.

Deri më tani, përveç objektit të Konsullatës në Strasburg të Francës, Kosova ka blerë edhe objektet e ambasadave në Shtetet e Bashkuara, Mbretëri të Bashkuar, Kroaci dhe Senegal.

Kosova ka gjithsej 42 misione



diplomatike në mbarë botën, përfshirë ambasada dhe konsullata. Këtu, po ashtu, përfshihet edhe Zyra Ndërlidhëse në Serbi dhe Zyra për Interesa Ekonomike në Greqi.

Sipas uebfaqes së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pavarësinë e Kosovës e njohin më shumë se 110 shtete, ndër të cilat shumica nga Bashkimi Evropian si dhe ShBA-ja.



INTERVISTË ME ZOGE SHALËN, ANËTARE E GRUPIT TË TË RINJVE TË PEJËS TË PAJTIMIT TË GJAQEVE NË KOSOVË 1990-1991

Pajtimi i gjaqeve ishte me rëndësi jetike për luftën çlirimtare në Kosovë

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 TETOR - Zogë Shala burgoset një javë pasi që i kishte mbushur 18 vjet, më 19 dhjetor 1984, për veprimtari politike patriotike, si pjesëtare e Organizatës Patriotike "Ideali". Dënohet me tri vjet burg. Prej tyre i vuan dy: Në burgun e Mitrovicës një vit e tetë muaj, ndërsa katër muajt e fundit në Lipjan. Lirohet nga burgu më 1 shkurt 1987.

Ani pse e kishte vuajtur dënimin me burg, nuk i është hequr ndalesa e shkollimit. Në gjimnazin e Pejës nuk i pranohen dokumentet. Provon edhe në Gjakovë, në Klinë, në Prizren, por gjithnjë merr përgjigje negative. Me postë në zarf ia dërgojnë edhe vendimin që e ka të ndaluar shkollimin. Pas një viti i hiqet ndalesa. Regjistrohet së bashku me Myrvete Dreshaj, e cila tashmë kishte dalë nga burgu, dhe e përfundon vitin e katërt

përmes provimeve, sepse mundësi tjetër nuk i kishte dhënë pushteti.

Pasi e kryen gjimnazin në Pejë, shkon në Prishtinë për t'u regjistruar në fakultet në drejtimin e matematikës, si e rregullt, por vetë pushteti edhe këtu mori pjesë dhe e dërgoi në shkollën e lartë - me korrespondencë. Nuk pranohet në konvikt, sepse ishte e "papërshtatshme politikisht". Prandaj detyrohet që gjatë studimeve të banojë në banesë private.

Në vitin 1989, së bashku me Myrvete Dreshajn, Remzije Malajn dhe Haqif Arifin, organizojnë demonstratë e marsit '89, nga Qendra e Studentëve drejt rrugës për në Podujevë.

Demonstratat zgjasin tri ditë. Ia dalin t'i organizojnë tri ditë radhazi, përkundër faktit se kishte shumë gaz lotsjellës, rrahje e burgosje të demonstruesve nga ana e policisë. Ka qenë anëtare e Lëvizjes Popullore të Kosovës.

Së bashku me Myrvete Dreshajn ka marrë pjesë edhe në grevën e studentëve në sallën "25 Maji", në përkrahje të minatorëve. Së bashku edhe me Remzije Malaj, Nebahate Malaj, Shyhrete Kastrati dhe Zijadin Biçku, i organizojnë demonstratat nga fshati Hogosht e deri në qytetin e Kamenicës.

Zogë Shala bëhet që në ditët e para anëtare e grupit të të rinjve të Pejës (Have Shala, Myrvete Dreshaj, Adem Grabovci, Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj), nismëtarë të Aksionit të Pajtimin të Gjaqeve, pas arritjes së pajtimin të parë të Buçollëve të Raushiqit të Pejës, më 10 shkurt 1990, dhe nuk i është ndarë deri në përfundimin e tij. Kështu, numri i vajzave, ish-të burgosura politike, në raport me numrin e djemve, në këtë grup tani ishte katër me tre, në favor të vajzave. Kuptohet, bëhet fjalë për një periudhë të caktuar, pasi që Akile Dedinca

kthehet pas një kohe për ta përhapur pajtimin e gjaqeve edhe në vendbanimin e saj, Fushë-Kosovë. Porse, si bërthamë, grupi i të rinjve të Pejës do të ketë raport konstante, tri ish-të burgosura politike: Have Shala, Myrvete Dreshaj dhe Zogë Shala, dhe katër ish-të burgosur, po ashtu politikë: Adem Grabovci, Brahim Dreshaj, Lulëzim Etemaj dhe Ethem Çeku, i cili i ishte bashkëngjitur grupit në ndërkohë. Ndërsa dominimin në numër të të rejave në grup e arrin Luljeta Grabovci, studente, e cila i bashkëngjitet grupit që nga dita e parë e fillimit, për të mos u ndalur deri në përfundimin e veprimtarisë së Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve në Kosovë 1990-1991. Zogë Shala merr pjesë në Kuvendi I të Lëvizjes së Pajtimin të Gjaqeve, të mbajtur më 19 maj 1990 në Strellc të Epërm të komunës së Deçanit. Ajo, gjithashtu, ishte pjesëmarrëse edhe e Kuvendit II, që nën

drejtimin e Have Shalës mbahet më 18 nëntor 1990 në Osek Hylë të Gjakovës.

Zonja Shala, na thoni fillimisht, ju lutem, se në cilin Këshill të Pajtimin të Gjaqeve keni vepruar?

Zogë Shala-Malaj: Në Këshillin e Pejës, përkatësisht në Grupin e të Rinjve të Pejës, nismëtar të Aksionit për Pajtimin e Gjaqeve, Plagëve dhe Ngatërresave, ish-të burgosurit politikë Have Shala, Myrvete Dreshaj, Brahim Dreshaj, Adem Grabovci dhe Lulëzim Etemaj. Në fakt, angazhimi im për pajtimin e gjaqeve është më i hershëm. Ende pa u vendosur për të filluar aksioni (29 janar 1990) kemi biseduar me Havën te shtëpia ime. Havën e kam kushërirë dhe raportet tona kanë qenë të ngushta, mendimet tona ia shfaqnim njëra-tjetrës, aktiviteti ynë ka qenë, po ashtu, gjithnjë i përbashkët. Pastaj kam shkuar në Prishtinë, sepse kam pasur

provim në fakultet, por kycja ime direkte në aksion ka ndodhur pasi që u mbajt takimi në Raushiq, ku më 10 shkurt 1990 është arritur pajtimi ndërmjet Fazli dhe Idriz Buçollit.

Veprimtarinë time për pajtimin e gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave e kam zhvilluar, krahas qyteteve dhe vendeve të tjera, edhe në Tetovë e Gostivar si dhe në Bujanoc. Ndërsa në fshatrat Husaj e Dacaj kam marrë pjesë edhe në formimin e këshillave të pajtimit. Thënë të drejtën, të veprosh në këtë anë ka qenë pak e vështirë sepse asimilimi i shqiptarëve e kishte bërë bukur shumë të veten. Por, me ndihmën e të rinjve të këtyre dy fshatrave si dhe përkrahjen e Haxhi Lajqit, drejtor i shkollës në Dacaj, ia arritëm edhe ta formojmë këshillin edhe të pajtojmë gjaqe.

Ani pse në familjen tuaj mund të ketë qenë ndryshe, oda shqiptare tradicionalisht ka qenë e rezervuar për burra shkaku i mentalitetit patriarkal. A keni pasur hezitime të hyni në to, meqë kjo paraqiste thyerje "rendi", dhe si jeni ndier?

Zogë Shala-Malaj: Ashtu është. Unë e kam pasur përkrahjen e nevojshme të familjes, prandaj edhe më kanë kuptuar për vendimet që kam marrë. Qëllimi i aksionit për pajtimin e gjaqeve ka qenë falja e gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave, në mënyrë që të pajtohej e bashkohej populli ynë i shtypur, për sfidat e reja që do ta prisnin në rrugëtimin e mëtejshëm për t'u çliruar dhe fituar lirinë. Prandaj, nuk kam pasur fare hezitim të hyj nëpër oda të familjeve të hasmuara. Thjesht kam qenë e bindur se do ta thyejmë mentalitetin patriarkal dhe "rendin", dhe se do të falen gjaqet, plagët dhe ngatërresat. Por, po, kam pasur një lloj emocioni se si do të na presin kur të hyjmë në ato familje, se si do të reagojnë, por assesi hezitim. Hyrja në odën e burrave për ne vajzat ka qenë temë më vete. E mbaj mend shumë mirë hyrjen në shtëpinë e Fatmir Ukës dhe Gani Dacit, që të dy të vranë në demonstratë nga forcat serbe. Për ne ajo ka qenë thyerje e çdo tabuje, çdo paragjykimi, çdo pengese dhe kështu është dëshmuar se nuk janë vetëm burrat ata që duhet të jenë nëpër oda.

Pushteti serb ka qenë kategorikisht kundër pajtimit tonë

Dhe, a jeni përballur me paragjykime?

Zogë Shala-Malaj: Me paragjykime jam përballur edhe para pajtimit të gjaqeve.


Shkaku i tyre dhe jo vetëm, kur jam burgosur për veprimtari politike me Have Shalën, kanë dashur t'i distancojnë familjet tona prej fshatit, të mos hyjë e të mos dalë askush prej banorëve të fshatit në familjet tona. Duhet veçuar me këtë rast për të mirë kryeplakun e fshatit, Zeqir Uka Shala, i cili, në një takim të mbajtur në fshat, nuk ka lejuar një gjë të tillë, duke u shprehur: "Këtë punë që e kanë bërë këto vajza të këtyre dy familjeve unë e kam pritur prej djemve tanë". Pastaj nuk ka pas fjalë të tjera. Na kanë përkrahur saqë pas daljes tonë nga burgu, së bashku me Havën kemi shkuar nëpër familjet e bashkëfshatarëve, kemi biseduar gjerësisht me ta dhe i kemi bindur që vajzat e fshatit tonë ta vazhdojnë shkollimin.

A e ka nxitur pjesëmarrja juaj në pajtime edhe dhënien e mendimit, madje edhe vetë vendimmarrjen e femrave të tjera nga familjet që kanë falë plagë, gjaqe dhe ngatërresa?

Zogë Shala-Malaj: Po. Gjithsesi. Një shembull konkret: Në fshatin Zllapek të Pejës nëna Nuriye Kunraj na ka falë gjakun e burrit pa lejen e djemve, apo familjarëve të tjerë. Kuptohet, ky nuk është rasti i vetëm. Ka pasur edhe shumë raste të tjera.

Të qenët femër dhe ish-e burgosur politikisht, ka qenë përparësi apo, mbase, edhe e metë që ka ndikuar në suksesin e përgjithshëm të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1991?

Zogë Shala-Malaj: Në asnjë mënyrë dhe asnjëherë s'e kam parë si hendikep. Përkundrazi, konsideroj se ka qenë përparësi. Sepse rënia në burg për çështje politike e një pjesëtari të familjes e posaçërisht femrës ishte akt guximi dhe atdhetarie që, përkundër rreziqeve që sillte me vete nga pushteti, vlerësohej lart dhe nderohej nga populli. Prandaj, duke pasur parasysh edhe qëndrimin tonë, sjelljen tonë dhe misionin që kishim marrë mbi vete, ani pse me përplot rreziqe, sepse pushteti serb ka qenë kategorikisht kundër pajtimit ndërshqiptar, populli na ka pritur e përkrahur fuqimisht, gjë që është vlerësuar lart dhe lavdëruar nga ana jonë. Andaj, edhe nuk ka munguar sukcesi i Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve. Të ishe një ish i/e burgosur politikisht dhe të hyje më pastaj në mesin e popullit, t'ia prekësh me kujdes njërën nga plagët më të rënda, siç ishte gjakmarrja, dhe të të kuptonte, të ngruhej në këmbë të ta falë gjakun në emrin tënd, pra rinisë, Kosovës dhe flamurit kombëtar, them se ka qenë një privilegj i jashtëzakonshëm jetësor.



Si është parë pjesëmarrja juaj në pajtime në rrethet e tjera, jashtë vendlindjes dhe komunës së banimit tuaj?

Zogë Shala-Malaj: Është parë në mënyrë shumë konstruktive. Si diçka krejt normale dhe thjesht një mision, që për t'u përmbushur do të thoshte që herëdoherë do të trokisnim edhe në derën e tyre për ta kërkuar faljen e gjakut, plagës apo ngatërresës dhe shtrirjen e dorës së pajtimit. Për një kohë shumë të shkurtër emrat tanë u njohën në gjithë Kosovën dhe pritej që një ditë do të shkonim edhe te ta.

A keni përjetuar ndonjë rast në familjet që keni kërkuar faljen e gjakut, plagës apo ngatërresës

kur e keni ndier vetën të mosrespektuar sa duhet dhe, rrjedhimisht, të tepërt?

Zogë Shala-Malaj: Në fillim ka qenë shumë vështirë, sepse ka pasur raste shumë të rënda për faljen e gjakut. Por, dita-ditës u mësuam dhe me një angazhim maksimal së bashku me shokët e fituam besimin, mirëkuptimin dhe mbështetjen. Nuk më ka ndodhur të mos jem respektuar. Përkundrazi, ka raste kur mua direkt ma kanë falë gjakun. "Gjakun po ta fali ty dhe Kosovës", këto ishin zakonisht fjalët e tyre. Një ndjenjë dhe përjetim i veçantë, që nuk do t'i harroj përjetë dhe që më bën të vazhdoj t'i çmoj shumë të gjitha ato familje të mrekullueshme, shpirtbardha dhe atdhetare, që

falën gjakun apo plagën e më të dashurve të tyre, që ne të rinjve na dhanë krah dhe forcë për të ecur përpara dhe përmbushur misionin tonë.

Si femër, a mendoni se e keni pasur mirëkuptimin e duhur, korrektësinë dhe respektin adekuat nga ana e bashkëveprimtarëve?

Zogë Shala-Malaj: Pa asnjë diskutim të vetëm. Unë në këtë rast mund të them sërish se pa bashkëpunimin, mirëkuptimin e plotë, korrektësinë dhe respektin adekuat të bashkëveprimtarëve tanë, edhe përkundër punës së pështur që është bërë gjatë gjithë javëve dhe muajve, nuk do të kishim mundur t'ia arrinim suksesit.

(Vijon)

Krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe në veri të Kosovës, domosdoshmëri apo obligim ndërkombëtar?



Shkruan:
Prof. dr. Fejzulla BERISHA

Çështja e krijimit të Asociacionit të Komunave Serbe në veri të Kosovës është një nga temat më të ndjeshme dhe të debatueshme në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Debatit përqendrohet në dy pyetje kryesore: A është ky Asociacion një domosdoshmëri për paqen dhe stabilitetin në rajon, apo është thjesht një obligim ndërkombëtar që Kosova duhet të përmbushë në kuadër të marrëveshjeve të ndërmjetësuar ndërkombëtarisht? Nga njëra anë, domosdoshmëria mund të lidhet me nevojën për të përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike brenda Kosovës dhe për të normalizuar marrëdhëniet me Serbinë. Mbështetësit e kësaj ideje argumentojnë se Asociacioni mund të ndihmojë në integrimin e komunitetit serb, duke krijuar një platformë që adreson nevojat e tyre specifike dhe zbut tensionet ekzistuese. Nga ana tjetër, themelimi i Asociacionit është një obligim ndërkombëtar që buron nga marrëveshjet e Brukselit të vitit 2013 dhe 2015. Kosova është nën trysinë e komunitetit ndërkombëtar, sidomos Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të përmbushur këto obligime. Respektimi i marrëveshjeve është parë si thelbësor për ruajtjen e besueshmërisë ndërkombëtare të Kosovës dhe përparimin e saj në rrugën e integritimit evropian.

Kundërshtarët e Asociacionit, si kryeministri Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje, e shohin atë si një kërcënim për sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës. Ata theksojnë se një asociacion me kompetenca të gjera mund të minojë shtetin unitar të Kosovës, duke krijuar një strukturë paralele, e ngjashme me Republikën Srpska në Bosnjë dhe Hercegovinë, që shpesh është burim bllokimesh politike dhe ndarjesh etnike. Frika se Serbia do të përdorë Asociacionin për të fuqizuar ndikimin e saj në Kosovë dhe për të krijuar një entitet të ngjashëm me Republikën Srpska është kyç për kundërshtimin. Në këtë kontekst, çdo formë e Asociacionit duhet të jetë e kufizuar dhe të respektojë parimet e Kushtetutës së Kosovës. Një Asociacion pa kompetenca ekzekutive, që funksionon brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës dhe me garanci të forta

ndërkombëtare, veçanërisht nga ShBA, shihet nga shumë si një zgjidhje e pranueshme. Një kompromis i tillë do të qetësonte tensionet dhe do të ruante sovranitetin e Kosovës, duke adresuar shqetësimet e komunitetit serb. Komentet e ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit, James O'Brien, sugjerojnë një proces ku Kosova mund të dërgojë draftin e projekt-statutit mbi Asociacionin e Komunave me shumicë serbe për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, por po ashtu lënë hapësirë për kompromise në të drejtën ndërkombëtare. Asociacioni ka qenë një pikë përçarëse mes Kosovës dhe Serbisë, me shqetësime se ai mund të përbëjë rrezik për funksionimin shtetëror të Kosovës nëse do të kishte kompetenca ekzekutive. Një kompromis i përmendur nga O'Brien dhe mbështetur nga

diplomacia ndërkombëtare mund të jetë një Asociacion pa kompetenca ekzekutive, i cili do të garantonte ruajtjen e sovranitetit të Kosovës. Në këmbim, Kosova mund të përfitonte nga garanci ndërkombëtare që do të përshinin avancimin e njohjes së saj nga pesë vendet e BE-së që ende nuk e kanë njohur dhe ndoshta, përsheptimin e anëtarësimit në organizata si NATO dhe OKB. Ky kompromis do të kërkonte një balancë mes nevojave të Kosovës për ruajtjen e sovranitetit dhe kërkesave ndërkombëtare për të respektuar marrëveshjet e mëparshme me Serbinë, të tilla si Marrëveshja e Brukselit. Nëse Asociacioni krijohet pa mbikëqyrje dhe garanci ndërkombëtare të fuqishme, mund të çojë në destabilizimin e Kosovës dhe të minojë funksionalitetin e saj si shtet.

Ndikimi i madh i Serbisë mbi këtë strukturë mund të krijojë një entitet paralel, që sfidon autoritetin e qeverisë qendrore dhe përforcon ndarjet etnike. Në këtë kontekst, shumë mendojnë se është më mirë që Asociacioni të mos krijohet, derisa të arrihen garanci të forta se ai nuk do të përdoret si një mjet politik nga Serbia për të minuar sovranitetin e Kosovës. Nga ana tjetër, përkrahësit e Asociacionit theksojnë se Kosova ka obligime ndërkombëtare që duhet t'i përmbushë dhe se respektimi i këtyre marrëveshjeve është kyç për stabilitetin rajonal dhe përparimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Çështja mbetet komplekse, pasi kërkon një ekuilibër të kujdesshëm mes ruajtjes së sovranitetit të Kosovës dhe përmbushjes së obligimeve ndërkombëtare për të siguruar stabilitetin dhe bashkëjetesën në rajon.



Sllovakia do ta mbyllë Zyrën Ndërlidhëse në Kosovë



PRISHTINË, 23 TETOR - Sllovakia, shtet që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, do ta mbyllë Zyrën e saj Ndërlidhëse në Prishtinë më 31 dhjetor të këtij viti. Nga Ministria e Jashtme e Sllovakisë thanë për "Radion Evropa e Lirë" se mbyllja e kësaj zyre është në kuadër të rritjes së strukturimit të rritjes diplomatike dhe zvogëlimit të buxhetit. Ndërkaq, Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës (MPJD) tha për "REL"-in se, përveç zyrës në Kosovë, Sllovakia do t'i mbyllë edhe ambasadat e saj në Danimarkë dhe Norvegji, si dhe konsullatat e përgjithshme në Krakovë dhe

Shën Petersburg. "Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, bazuar edhe në sqarimet e këtij njoftimi, vlerëson se vendimi është pjesë e një riorganizimi të brendshëm të rritjes diplomatike të Sllovakisë. Ristrukturimet e tilla të rrjeteve diplomatike në përputhje me objektivat strategjike dhe resurset e kufizuara janë evidente edhe në shtete të tjera", tha MPJD-ja në përgjigjen dërguar "REL"-it. Në uebfaqen e Zyrës Ndërlidhëse të Sllovakisë në Prishtinë thuhet se pavarësisht mbylljes së zyrës, "shërbimet për qytetarët sllovakë dhe raportet diplomatike do të mbahen në bazë të kornizës së

operacioneve nga ambasadat sllovaqe në shtetet fqinje". Ndërkaq, MPJD-ja tha se, pavarësisht prej vendimit për mbylljen e Zyrës Ndërlidhëse, Kosova është e përkushtuar t'i forcojë raportet me Sllovaqinë, "qoftë nëpërmjet Zyrës Ndërlidhëse, qoftë përmes takimeve në forume të tjera në nivel rajonal, evropian dhe global". Sllovakia, së bashku me Spanjën, Qipron, Greqinë dhe Rumaninë, janë shtetet e BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Bratisllava ka raporte të mira me Serbinë dhe e konsideron Beogradin partner kyç në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

USAID-i shënon 25-vjetorin e ekzistencës në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 TETOR - Drejtoresha e Degës së Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë, Mary Eileen Devitt, ka thënë se prej vitit 1999 kjo agjenci amerikane ka investuar më shumë se 1 miliard dollarë në zhvillimin e Kosovës. Ajo i ka bërë këto deklaratë në ceremoninë e shënimit të 25-vjetorit të ekzistencës së USAID-it në Kosovë, duke përmendur se USAID-i ka ndihmuar në rindërtimin e shumë institucioneve dhe infrastrukturës së shkatërruar gjatë luftës së fundit në Kosovë. Sipas saj, në 25 vjetët e fundit Kosova është bërë vend modern, dhe duhet të qëndrojë konsistent me vlerat e veta për ndërtimin e një shoqërie demokratike shumëtnike.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se vendi i tij është krenar për gjithçka që ka arritur Kosova në periudhën e pasluftës, edhe pse në vitin 1999 nuk kishte shumë optimizëm. "Ne nuk kemi mundur, dhe nuk kemi dashur që populli i Kosovës të mbetet



vetëm. USAID-i ishte një domosdoshmëri në atë kohë, për ta ndihmuar popullin e Kosovës që të shërohet nga ngjarjet e luftës dhe të fillojë të shikojë drejt një të ardhmeje më të mirë dhe më të ndritshme", ka thënë ai. Megjithatë, ai e ka përmendur që, krahas zhvillimit aktual, vendi ka nevojë për zhvillim të vazhdueshëm.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka nisur një video-mesazh, duke thënë se ShBA-ja ka

investuar në ëndërrën e qytetarëve të Kosovës, në liri dhe përparim. "Na u dha një dorë gjatë regjimit të [liderit serb, Sllobodan] Millosheviqit, një dorë ndihme nga ShBA-ja, me mesazhin 'nuk do të jeni vetëm'. Tullë mbi tullë, shkollë më shkollë, projekt pas projekti, ju na ndihmuat të ndërtonim një të ardhme më të mirë", ka thënë ajo.

Edhe ajo e ka përmendur nevojën që Kosova të vazhdojë rrugën drejt një të ardhmeje më të mirë.

"Nuk ia dalim dot vetëm, ne kemi nevojë për një mik dhe një partner, dhe ShBA-ja është ajo". Në 25 vjetët e fundit programet e USAID-it janë fokusuar në luftën kundër korrupsionit, sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë, luftën kundër dezinformimit dhe avokimin e medieve të pavarura, forcimin e shoqërisë civile dhe demokracisë, zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Në gusht të këtij viti presidentja

Osmani e ka nënshkruar një grant me USAID-in, i cili ofron ndihmë shtesë për institucionet e Kosovës në vlerë prej 34.5 milionë dollarësh. Ai grant është pjesë e marrëveshjes së arritur më parë në vlerë prej rreth 146 milionë dollarësh, që synon ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët, rritjen e përgjegjësisë së institucioneve dhe menaxhimin më efikas.

Ambasadori Hovenier ka theksuar më herët se mbështetja e qeverisë amerikane për popullin e Kosovës është më e fortë se kurrë, dhe se nuk do të ndalet përkundër disa mosmarrëveshjeve me qeverinë e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti.

Me mosmarrëveshje kryesisht u referohet hapave të ndërmarrë nga qeveria që kanë ndikim në komunitetin serb në Kosovë, si heqja nga përdorimi e dinarit serb, shpronësimi në veri të Kosovës për ndërtimin e bazave policore, mbyllja e institucioneve paralele, që funksionojnë sipas sistemit serb e të tjera.

ShBA-ja ka paralajmëruar disa herë se lëvizjet e "pakoordinuara" të qeverisë së Kurtit mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e partneritetit mes dy vendeve.

Beqiroviqi bën thirrje që Bosnjë-Hercegovina t'i heqë vizat për shtetasit e Kosovës

PRISHTINË, 23 TETOR - Kryesuesi i Presidencës trepalëshe të Bosnjë-Hercegovinës, Denis Beqiroviq, ka thënë në Sarajevë se pret që përfaqësuesit e Republikës Serpska nëpër institucione shtetërore t'i ndihmojnë Bosnjës në heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës.

Ai e ka komentuar vendimin e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, i cili ka bërë me dije, në organizimin e sivjetmë të Procesit të Berlinit, se prej 1 janarit të vitit tjetër shtetasit e Bosnjë-Hercegovinës do të mund të hyjnë në Kosovë vetëm me letërnjoftime. Procesi i Berlinit nisi në vitin 2014 me iniciativën e kancelares së atëherëshme gjermane, Angela Merkel.

Synimi i samiteve të tij, të cilat mbahen çdo vit, është ta rrisin bashkëpunimin mes vendeve të Ballkanit Perëndimor - Kosovës,

Shqipërisë, Serbisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut - dhe gradualisht t'i afrojnë ato më pranë BE-së. "Pas këtij vendimi të marrë nga Kurti, pres që edhe brenda Bosnjë-Hercegovinës, kur është fjala për përfaqësuesit e entitetit të Republikës Serpska nëpër institucione shtetërore, që të na ndihmojnë në marrjen e hapave adekuatë për t'i zbatuar plotësisht marrëveshjet që ka nënshkruar Bosnjë-Hercegovina në kuadër të Procesit të Berlinit", ka thënë Beqiroviqi pas takimit me presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj, i cili gjendet për vizitë në Bosnjë.

Prej janarit të këtij viti shtetasit e Kosovës mund të udhëtojnë lirshëm në vendet e zonës Schengen, por ende u duhet vizë për të hyrë në Bosnjë-Hercegovinë për shkak të



kundërshtimeve të përfaqësuesve të entitetit serb, Republikës

Sërpska. Bosnjë-Hercegovina nuk e njeh

shtetësinë e Kosovës.

Në konferencën për medie, të mbajtur me presidentin e Shqipërisë, Beqiroviq e ka përshkruar Kurtin si "mik të mirë" dhe vendimin e tij për heqje vizash si "të pazakonshëm në këtë rajon". "Është e rëndësishme për gjithë Bosnjën dhe për gjithë rajonin, dhe ne duam të dërgojmë mesazh të rëndësishëm", ka thënë Beqiroviqi kur ka bërë thirrje për zbatim të plotë të marrëveshjeve të nënshkruara në kuadër të Procesit të Berlinit.

Një prej marrëveshjeve të arritura është edhe heqja e regjimit të vizave në mes të Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës, por ajo nuk është ratifikuar ende nga Parlamenti i Bosnjë-Hercegovinës. Ratifikimi është bllokuar nga përfaqësuesit e autoriteteve të Republikës Serpska, të udhëhequr prej partisë së Millorad Dodikut.



Aktakuzë ndaj një personi për "fshehje të terroristëve"

PRISHTINË, 23 TETOR - Prokuroria Speciale e Kosovës tha se ka ngritur aktakuzë ndaj një personi i cili dyshohet se ka kryer veprën penale të "fshehjes ose moslajmërimit të terroristëve dhe grupeve terroriste". Sipas njoftimit, K. H. është takuar dhe ka marrë pjesë në biseda të vazhdueshme me nëntë persona, të identifikuar

vetëm me iniale, të cilët veçse janë të dënuar për vepra të terrorizmit.

Prokuroria Speciale tha se K. H. "ka qenë në dijeni për ekzistimin dhe veprimet e këtij grupi terrorist, por i njëjti i kishte fshehur dhe nuk i kishte lajmëruar tek organet kompetente". Organi i akuzës ka kërkuar që të

akuzuarit t'i vazhdohet arresti shtëpiak deri në përfundimin e rastit penal ndaj tij. Sipas ligjeve në Kosovë, për vepra terroriste parashihen dënime të ndryshme. Po ashtu, që nga viti 2015 Kosova ndalon pjesëmarrjen në luftërat e huaja dhe për këtë veprë penale parashihen dënime deri në 15 vjet burgim.

Tollovia në Merdar u kushton bizneseve



PRISHTINË, 23 TETOR - Dy javë pasi Kosova e hoqi pjesërisht ndalimin e importit të mallrave nga Serbia, kolona prej kilometrash në anën serbe të pikës kufitare Merdar nuk është duke u zvogëluar. Në kolonë presin disa ditë edhe transportuesit që janë vetëm transit nëpër Kosovë, ose transportojnë mallra që nuk kanë origjinë nga Serbia.

Në një deklaratë për "Radion Evropa e Lirë", Ambasada e Gjermanisë në Kosovë tha se "do të dëshironim që mallrat të lëviznin më shpejt përmes pikës kufitare", por theksoi se rikthimi i importit direkt nga Serbia në Kosovë është një "arritje e rëndësishme". "Para së gjithash, është e rëndësishme të pranohet se vendimi [për heqjen e ndalimit të importit të mallrave nga Serbia] është duke u zbatuar", tha Ambasada Gjermane, duke shtuar se duhet bërë më shumë punë për lëvizjen më të shpejtë të mallrave në kufi.

Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, tha më herët se do ta monitorojë procesin e importit të mallrave nga Serbia, pasi vendi i tij i kërkoi Kosovës heqjen e ndalesës në mënyrë që të zhblllokohej CEFTA, apo Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore, dhe të përparonte Procesi i Berlinit - një nismë kjo që synon ta ndihmojë zhvillimin ekonomik të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe afrimin e tyre me Bashkimin Evropian.

Më 7 tetor Qeveria e Kosovës e zëvendësoi vendimin për ndalimin e importit të mallrave me origjinë nga Serbia me një të ri që lejon importin, por vetëm përmes kufirit në Merdar dhe me kontroll të hollësishëm të sigurisë. Në vendkalimet e tjera u paralajmërua se do të lejohet importi vetëm kur të sigurohen skanerët, të cilët do t'i ndihmojnë Doganës së Kosovës për kontrollin e mallrave pa ndërhyrje fizike.

Ambasada Gjermane tha se blerja e këtyre skanerëve është në proces, "në përputhje me të gjitha rregullat dhe rregulloret e vlefshme për prokurimin publik". Përndryshe, Kosova thekson se vendimi për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia, në mes të korrikut të vitit 2023, u mor për "arsye sigurie", pas arrestimit të tre policëve të Kosovës nga policia serbe.

Më 17 tetor, kryeministri i Serbisë, Milosh Vuçević, i bëri përgjegjëse autoritetet e Kosovës për krijimin e kolonave të kamionëve në Merdar, duke thënë se ato po bëjnë gjithçka "për ta vështirësuar importin e mallrave serbe". Ai tha se "bëhen ekzaminime të gjata të panevojshme, vetëm për t'i nervozuar njerëzit".

Qeveria e Kosovës nuk iu përgjigj kërkesës së "REL"-it për t'i komentuar këto pretendime, si dhe për të shpjeguar se përse importimi apo transiti në Merdar po zhvillohet me vështirësi.

Ngjashëm nuk u përgjigj as Dogana e Kosovës.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të "REL"-it, Oda Ekonomike e Serbisë tha se qarkullimi i lirë i mallrave, aktualisht, është i vështirë në terren dhe se heqja e pjeshme e ndalesës për importin e mallrave nga Serbia ka pasur kundëreffekt - në vend të qarkullimit të lirë të mallrave, ka bllokadë në Merdar.

Kush është përgjegjës për kolonën prej disa kilometrash?

Aleksandar Radovanović, kryetar i Qendrës për Bashkëpunim Rajonal në Odën Ekonomike të Serbisë, konsideron se Dogana e Kosovës po punon ngadalë, me "urdhrit e autoriteteve të Kosovës", për ta vështirësuar importin e mallrave nga Serbia. Ai thekson se para ndalimit të importit të mallrave nga Serbia, në Merdar kanë hyrë mesatarisht rreth 250 kamionë në ditë, ndërsa që nga heqja e ndalesës, më 7 tetor, në Kosovë kanë hyrë 30 deri në 40 kamionë.

Dogana e Kosovës tha për "Radion Evropa e Lirë" më 14 tetor se mesatarisht brenda ditës në Kosovë hyjnë tetë kamionë me mallra nga Serbia.

Mirëpo, më 18 dhe më 21 tetor, Dogana nuk iu përgjigj pyetjeve se përse kamionët që transportojnë

lëndë të parë nga Serbia, duhet të kalojnë ekskluzivisht në vendkalimin në Merdar, siç i thanë "REL"-it disa transportues dhe Oda Ekonomike e Serbisë.

Dhjetë ditë pas ndalimit të importit të mallrave nga Serbia, në korrik të vitit të kaluar, Qeveria e Kosovës e ndryshoi vendimin e saj dhe lejoi vetëm importin e lëndëve të para nga ky vend.

Por, Sadri Selimi, i cili importon grurë nga Serbia në Kosovë, thotë se që nga 7 tetori autoritetet e Kosovës lejojnë importin e lëndëve të para vetëm përmes Meradrit dhe se edhe ato i nënshtrohen një kontrolli të detajuar - çfarë nuk ishte praktikë më herët.

Për situatë të ngjashme flet edhe Radovanović: "Lëndët e para janë shpërndarë normalisht gjatë gjithë kohës, kanë mundur të hyjnë në të gjitha vendkalimet dhe papritmas edhe kjo bëhet çështje sigurie". Radovanović vlerëson se nuk ka vullnet politik që qarkullimi i lirë i mallrave të ekzistojë realisht në terren.

Cila është zgjidhja?

Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, thotë se autoritetet e Kosovës duhet t'i rrisin kapacitetet e tyre në Merdar në mënyrë që të zvogëlohet kolona e transportuesve që presin me ditë të tëra për ta kaluar kufirin. Ai, gjithashtu, beson se kontrolli i

detajuar i sigurisë, mund të kryhet manualisht në vendkalimet e tjera, derisa të mbërrijnë skanerët. Sipas tij, situata aktuale "nuk ka kuptim".

Nëse nuk ndërmerret asgjë, thotë Shahini, transportuesit dhe kompanitë do të kenë humbje të madhe financiare, e cila do të shkaktojë rritje të çmimeve. "Aty [në Merdar] ka mallra që prishen, ka mallra që transportohen në vende të tjera, kështu që ky problem duhet të zgjidhet sa më shpejt. Biznesmenët kanë humbje, për shkak të pritjes. Çdo ditë kushton dhe askush nuk përfiton", thotë Shahini.

Radovanović, në anën tjetër, thotë se ka një interesim të madh të biznesmenëve kosovarë dhe serbë për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin, por se, aktualisht, po u dërgohet mesazhi se "një gjë e tillë nuk është e dëshirueshme". "Kur i mbani shoferët e kamionëve për disa ditë në kushte që nuk janë të denja për njeriun, asnjë transportues nuk do ta pranojë ofertën e një prodhuesi që dëshiron të dërgojë mallra në Kosovë", thotë ai.

Produktet nga Serbia, prej vitesh, janë ndër më dominueset në tregun kosovar.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2022, Kosova importoi mallra nga Serbia në vlerë prej mbi 372 milionë euro, ndërsa në vitin 2023 kjo vlerë ishte gati 199 milionë euro.

Një pronë e APK-së, afër objektit të qeverisë, i kthehet Ministrisë së Bujqësisë

PRISHTINË, 23 TETOR - Pas më shumë se 20 vjetësh, prona e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, e cila gjendet në qendër të Prishtinës, në afërsi të objektit të qeverisë, i kthehet titullarit të saj, pra Ministrisë së Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural. Me përkushtim dhe vendosmëri të të gjithë aktorëve dhe me iniciativën e vazhdueshme të ministrit të

BPZHR-së, Faton Peci dhe përpjekjet e tij që ta mbajë premtimin e dhënë për rikthimin e pronave të MBPZHR-së, edhe kjo pronë iu kthye pronarit legjitim të saj për t'u shfrytëzuar për nevojat e institucionit.

"Jemi të angazhuar për të siguruar që të gjitha pronat që i takojnë ligjërisht MBPZHR-APK të merren në posedim dhe të menaxhohen në

mënyrë efektive dhe nuk do të ndalemi deri në rikthimin e të gjitha pronave të tjetërsuara", tha ministri Peci.

APK pas identifikimit ka rikthyer në posedim të saj pronën/objektin prej 138 m² në Prishtinë, e cila, sipas Ligjit për Pyjet, i aprovuar vitin e kaluar, është pasuri shoqërore që i takon dhe i kalon për menaxhim Agjencisë Pyjore të Kosovës.



PRESIDENTJA E RADOIÇIQT!



Behxhet Sh. SHALA- BAJGORA

Rrena i ka këmbët e gjata, një mandat të plotë: Kosova po përballlet me probleme të natyrës së mbijetesës, qytetarët me shumë probleme ekonomike, Kosova me shumë probleme politike dhe statutore. Pas zgjedhjeve të shkurtit 2021 sikur u rritën shpresat për një të ardhme më të mirë, kështu premtonte Mesia i 50 përqindëshit, KM Albin Kurti. Euforia kaloi në delir të fitores dhe, me kalimin e kohës kur u zhvesh kallaji nga flakërimi i arit, ky delirij kaloi në histeri ndaj të gjithë atyre që guxonin ta kundërshtonin Mesian karizmatik të koalicionit multietnik që udhëhiqej nga LV-ja. Urrejja, me përmasa të një patologjie ishte kundër heronjve të luftës dhe të paqes që u dërguan në Hagë, ndaj luftës së lavdishme të UÇK-së, ish të burgosurve politikë dhe kritikuesve të regjimit të Kurtit. Pasi partitë opozitare ishin në gjendje të shokut postraumatik, shkaku i rezultateve të zgjedhjeve, pozita dhunuese përdori brutalitet të paparë që ta groposë përfundimisht duke i quajtur shkatërrues të shtetit ndonëse këta pikërisht ishin ndërtues të shtetit. Me kalimin e kohës u pa se pozita nuk ishte në gjendje as ta mirëmbajë atë që e kishte trashëguar prej “shkatërruesve të shtetit” e lërë më të përmbush premtimet gjatë fushatës që dolën të jenë mashtrim ordiner në luftë për pushtet. Pozita është në fund të mandatit të plotë qeverisës pa bërë asnjë ndryshim që do ta përmirësonte cilësinë e jetës së qytetarëve të Kosovës. Çmimi i rrymës është dyfishuar sikur që janë rritur çmimet e artikujve të domosdoshëm për shportën familjare duke i bërë të papërballueshëm për shumë qytetarë. Pensionistët u sollën buzë vdekjes klinike, në fund të mandatit u rritën 20 për qind ndërkaq që nuk pati fare indeksim apo përputhje me rritjen e çmimeve. Realisht, me këtë rritje, vlera e pensionit është vetëm 80 për qind e vlerës reale. Shifrat për zhvillim ekonomik,

punësim dhe investime nga jashtë janë improvizim ordiner që kundërshtohen tërësisht nga raportet ndërkombëtare sikur edhe nga enti statistikor i Kosovës. Ministri i Finance është një mashtrues të cilit nuk i gjendet shoqi, është mashtrues që as gjenetika më e përparuar nuk mund ta klonojë. Korrupsioni, që u përdorë si armë nukleare kundër “shkatërruesve të shtetit”, gjatë këtij mandati qeverisës u bë dukuri endemike, nuk mbeti ministri a tjetër institucion pa u përfshirë, kokë e këmbë. Prej investimeve kapitale, po të mos ishte Ura e Saradranit, si vepër madhështore, qeveria do të mbetej e cullakosur nga argumentet. Asnjë qeveri deri më tani nuk e ka shkelur aq brutalisht pavarësinë e gjyqësorit dhe institucioneve tjera të pavarura sa qeveria Kurti 2. Asnjë qeveri deri më tani nuk i ka përndjekur ushtarët e UÇK-së dhe të burgosurit politikë sa kjo qeveri. Asnjë qeveri deri më tani nuk i ka sistemuar dhe rehatuar ish-udbashët dhe shërbëtorët e regjimit jugosllav dhe qeveria aktuale. Të gjitha qeveritë e pasluftës, së bashku nuk kanë punësuar anëtarë të partisë dhe familjarë sa qeveria Kurti 2. Specialitet efikas për korrupsion janë treguar tenderët njëburimorë, deri kur një SPAK i Kosovës të merret me to. Qeveria Kurti 2 i ka duart e lira të bëjë atë që e bënë sepse e ka të qartë se prioritet i ndërkombëtarëve nuk është lufta kundër korrupsionit por arritja e një marrëveshjeje me Serbinë. Pastaj do ta zbatojnë praktikën e Shqipërisë kundër korrupsionit. Prandaj edhe tolerojnë që analfabetët e MD të ndërhyjnë në punët e gjykatave dhe të Prokurorisë, i durojnë tenderët njëburimor, punësimet partiake dhe nepotizmin. Në planin ndërkombëtar, Kosova është nën sanksione, Serbia po faktorizohet shumë, nuk kemi asnjë njohje të vetme, dështuam të


anëtarësohemi në Këshillin e Evropës, në Interpol sikur edhe në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë. Dështim pas dështimi. Krijua marrëdhënie armiqësore me Shqipërinë, e arritëm një marrëveshje kriminale me Danimarkën, pranua shkatërrimin e shtetit përmes Marrëveshjes së Brukselit dhe Aneksit të Ohrit, u manipulua fëmijërisht, së pari nga Merkel e pastaj nga Sholc të cilët e ngritën Serbinë dhe Vuçiçin sikur Feniksin. Albin Kurti u vë në izolim ndërkombëtar, vetëm kur bënte lëshim ndaj kërkesave të ndërkombëtarëve e që përputheshin me ato të Serbisë, përkohësisht zbutej, nuk hiqej, izolimi. Kam i bindur se Kurti do ta përmbushë çdo kërkesë të ndërkombëtarëve, për të mbetur në pushtet, vetëm po blenë kohë që si një striptizetë politike të mos lakuriqohet menjëherë por t'i heq robat e në veçanti mbathjet, një nga një. Atë që u deklarua pas takimit me O'Brajen ishin të kundërta me atë që u bisedua brenda dhe gjatë takimit. Së shpejti e shohim përmes Besnik rrencit. Para zgjedhjeve Kurti luan me karta të forta të folklorit patriotik, me verium e Kosovës, kërkesën për ekstradim të Radoiçiqit, anëtarësim në KIE, NATO dhe Aleancën e Gjylekarit. Lëshimet më të mëdha Kurti do t'i bëjë në veri të Kosovës, pa asnjë dyshim. Pa këtë lëshim nuk ka Këshill të Evropës. Për anëtarësim në NATO u deklarua z. shefi i saj kur tha se nuk është as në diskutim kjo çështje. Tash, ka anëtarë të shoqërisë civile që për një projekt e bëjnë Asociacionin ashtu si e do Serbia. Ka politikan që kërkojnë garanci nga NATO dhe BE për ta dërguar Asociacionin në Kushtetuese. Ose janë të papjekur, ose karrieristë të krimbur. Edhe Ukraina kishte garanci nga ndërkombëtarët se do të mbrohej nga ata nëse i dorëzon resurset nukleare. I dorëzoi dhe sot është shndërruar në shkretëtirë të

pajtueshme. Po të mos ishte mbrojtja e pakursyer e Vojsa Osmanit, Albin Kurtit, Besnik Bislimit dhe Donika Shvarc, Ukraina do të shlyhej nga harta botërore. Sanksionet e repta që ua vendosi Besnik Bislimi e pruri buzë falimentimin Rusinë. Megallomanë të pagdhendur, mashtrues brutal.

Përgjimet dhe bisedat: LV-ja dhe Vojsa Osmani nuk kanë lëshuar rast pa përmendur bashkëpunimin (vartësinë) e regjimit të vjetër me Listën Serbe dhe Radoiçiqin. Tash, pas bërjes publike të bisedave të Mimoza Kusarit me Simiqin dhe Radoiçiqin, deklarimeve të Gjet Pacollit, Adem Hoxhës dhe Gashit (deputetë mercenarë të Radoiçiqit në Kuvendin e Kosovës), po del sikur pozita aktuale apo regjimi i ri i Kurtit, jetësisht janë lidhur në raport vartësie të LS-së dhe Radoiçiqit. Sidomos gjatë votimit të Vojsa Odmanit për presidente. Të gjithë që e kanë përcjell votimin në Kuvend, unë isha aty tërë kohën, jemi dëshmitarë se dështuan dy votimet e para dhe rezultati ndryshoi pasi erdhën në Kuvend musketirët e Radoiçiqit, Hodza dhe Gaši. Ata e bënë Vojsën presidente, ishin vota përcaktuese. Nuk ka të keqe e as kundërligjore pse votuan por e keqja ishte se ishin vota klienteliste, të korruptuara e që u mohuan nga porositësit e këtij krimi votues, Mimoza Kusarit dhe padre padrinor, Albin Kurtit. Këtu nuk ka asgjë të paqartë, nuk ka pse të sulmohet as Pacolli e as publikuesit e përgjimeve. Përgjegjësia është e porositësve. Unë nuk shoh këtu përgjegjësi penale nëse nuk ka diçka që nuk dihet deri sot. Ndërkaq, në asnjë rrethanë nuk i nënshtrohen përgjegjësisë njerëzore, kombëtare, politike dhe morale. Nuk kanë asgjë të përbashkët me këto përgjegjësi, lakmia për pushtet i ka kastruar nga to!

Opozita po luan me karta blofi: Opozita gabon rëndë nëse fushatën

e mbështetë duke u marrë me Mimoza Kusarin dhe Dejana Mihaljin. Me Grupin e Tredhur të Anarkistëve të Tiranës që abuzojnë me buxhetin e Kosovës, marrin lekë për të punuar kundër Kosovës dhe Shqipërisë. Opozita duhet të merret me dështimet kapitale të pushtetit në shëndetësi, arsim, ekonomi, drejtësi, diplomaci, investime kapitale, nepotizëm, korrupsion, dhunim social të shtresave të marginalizuara etj. Nëse opozita mbështetet vetëm te “miqtë ndërkombëtarë” dhe izolimin e Kurtit, e pati puna e tyre, ikën përlesh. Kuvendi i ardhshëm do të jetë i baraspeshuar me vota ndërmjet LV-së, PDK-së, LDK-së, AAK-NISMA dhe Listës për Familje. Koalicionet do të jenë të pashmangshme dhe të nevojshme. Të gjithë deklarohen kundër koalicionit me LV-në. Mos iu besoni! Më së shumti ka nevojë për koalicion LV-ja, për të mbetur në pushtet dhe për të shpëtuar nga ndjekjet penale për korrupsion astronomik dhe gjithëpërfshirës. Për të amortizuar përgjimet dhe poshtërsitë që i kanë bërë sidomos me pengjet e Hagës. Albin Kurti, kryeministër, nuk e besoj. Albin Kurti - Vojsë Osmani, president, e mundshme, besoj. Faton Peci bëhet xherrah. Përparim Gruda, ministër i Drejtësisë, nuk është e pamundur. Nëse partitë opozitare bëjnë shumicën, LV-ja do të marginalizohet, deri në shpërbërje. Dikush në Dyz, dikush në Dubravë, dikush në Gjermani e në Angli, Shvajcari dhe Itali, Besnik Bislimi në Serbi (Luginë të Preshevës), bijat në opcinë (diasporë), dikush në Milloshevë e dikush në Malishevë... Deri atëherë gjërat edhe mund të ndryshojnë. E shohim, këtu jemi. Përfundimisht, Albin Kurtit i ka dalë situata nga kontrolli, është peng i ministrave dhe ministreshave të korruptuar, peng i premtimeve që nuk ka mundësi t'i realizojë. Është peng i Albin Kurtit apo egos tjetër sikur dr. Xhekilli. Peng i ndjenjës së madhështisë!



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

KB Vëllaznimi ndahet me trajnerin Branimir Paviq

Kroati Branimir Paviq më nuk është trajner i KB Vëllaznimit nga Gjakova. Ekipi i Superligës së Kosovës në basketboll të mërkurën ka njoftuar se ka ndarë rrugët me Paviqin, të cilin

e pati emëruar trajner para fillimit të këtij sezoni. "Me marrëveshje të dyanshme kemi ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Branimir Paviq, të cilin e falënderojmë për kontributin

në skuadër dhe i dëshirojmë suksese në vazhdimin e karrierës. Drejtuesit e klubit janë duke punuar për ta gjetur trajnerin e ri të ekipit sa më shpejt të jetë e mundur dhe për

ta vazhduar punën e rikthyer ekipin në rrugën e fitoreve", thuhet në njoftimin e skuadrës gjakovare. Pas gjashtë xhirove të zhvilluara deri më tani, Vëllaznimi zë vendin e gjashtë

në tabelë me dy fitore dhe katër humbje. Ndeshjen e radhës Vëllaznimi e luan në udhëtim kundër skuadrës së Sigal Prishtinës në kuadër të xhiros së shtatë.

Sermaxhaj: Dua ta nxjerr më të mirën nga vajzat e Kosovës

PRISHTINË, 23 TETOR - Kombëtarja e Kosovës në konkurrencën e vajzave ka filluar grumbullimin katërditor në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, ku për herë të parë vajzat u stërvitën nën drejtimin e përzgjedhësit të ri, Sami Sermaxhaj. Ky grumbullim ka për qëllim përgatitjen e ekipit për turneun ndërkombëtar që zhvillohet muajin e ardhshëm në Egjipt. Gjatë këtij kampi "Dardanet" do të zhvillojnë një ndeshje testuese kundër Kombëtares U19, e cila është caktuar të luhet të premten. Kjo ndeshje do t'i shërbejë trajnerit të ri për t'u njohur më mirë me ekipin dhe potencialet e secilës lojtare. Në stërvitjen e parë, përzgjedhësi Sermaxhaj dha udhëzimet e tij të para, duke shpjeguar qartë kërkesat e tij për fazat e ardhshme të punës me

ekipin. Ky grumbullim shërben gjithashtu si një mundësi e rëndësishme për futbollistet dhe trajnerin e ri që të krijojnë një lidhje më të fortë dhe të njohin më mirë njëri-tjetrin, me qëllim për të arritur performancë sa më të lartë në ndeshjet e ardhshme. "Është hera e parë që e drejtoj një kombëtare femrash. Ishte propozim i FFK-së dhe ideja e tyre ishte që jam personi i duhur për ta udhëhequr Kombëtaren A. Pak në fillim e mora me dilema, të them të drejtën, për arsye se nuk e kisha menduar asnjëherë më herët dhe nuk kisha shumë njohuri për futbollin e femrave. Por, ishte propozim i Federatës dhe arsyet që më dhanë ata më bindën që në këtë rast jo shumë privilegj, por më shumë përgjegjësi për këtë post dhe mendova se pse të mos kontribuoj për gjininë femërore të



shtetit tonë. Nga sot nuk kam dilema, do të punoj me përkushtimin më të madh që të jap më të mirën dhe të nxjerrim më të mirën prej vajzave që përfaqësojnë Kosovën. Federata ka një ftesë që të marrë pjesë në një turne në Egjipt, në një grup me Argentinën, Brazilin dhe Egjiptin. S'do mend se tradita e futbollit flet për ta, por do të shkojmë atje t'i

sfidojmë këto ekipe pa frikë. Ky turne do të na shërbejë që të krijojmë një grup sa më të mirë të futbollistëve për kualifikimet e ardhshme", ka theksuar Sermaxhaj. Ndërkohë futbollistet Ereleta Memeti dhe Lorita Islami theksuan se ky grumbullim do t'i shërbejë ta njohin më mirë strategjinë dhe vizionin e lojës së trajnerit të ri. "Sot ka qenë stërvitja e parë me

trajnerin e ri, dhe jemi përshëndetur dhe na ka treguar në teori se si e ka idenë për futbollin, derisa sot e kemi zbatuar në praktikë. Deri tani gjithçka po shkon mirë, kemi bashkëpunim mes vete, ka atmosferë në ekip dhe besoj se do ta kemi një të ardhme të suksesshme. Në këtë grumbullim kanë ardhur disa futbolliste të reja dhe disa futbolliste nga U19. Ato do të mësohen me rregullat e ekipit dhe bashkëpunimi besoj se do të jetë i mirë", ka pohuar Memeti. "Jam e lumtur dhe shumë krenare për ftesën e Kosovës sepse është mundësi dhe arritje e madhe në jetë, sidomos kur e ke familjen të Kosovës. Sot kemi zhvilluar stërvitje për të na njohur trajnerin si futbolliste në aspektin individual dhe për t'u njohur me njëra-tjetrën", ka shtuar Islami.



150 xhudistë nga vende të ndryshme po stërviten në Kosovë

PEJË, 23 TETOR - Kosova është bërë një nga vendet më tërheqëse për përgatitjen dhe stërvitjen edhe të xhudistëve nga vende të ndryshme të botës dhe në shumë raste ata qëndrojnë në Kosovë si grupe të ndryshme ku stërviten nga trajnerë të Kosovës në krye me Driton Kukën. Këto ditë në Kosovë po qëndrojnë

mbi 150 garues, derisa këtë herë po merr pjesë edhe ekipi i Moldavisë. Trajneri Driton Kuka ka thënë se sporti po thyen barrierat politike. "Pas Ballkanikut të mbajtur në Pejë po mbahet Kampi stërvitor i radhës! Specifike kësaj radhe pjesëmarrja e ekipit të Moldavisë, për herë të parë në

Kosovë. Ekipi i fortë e njerëz pozitiv dhe mirënjohës për mikpritjen që hasën në vendin tonë. Sporti po thyen gjithmonë barrierat politike dhe kjo do vazhdojë tutje. Përndryshe në Pejë po qëndrojnë 150 garues në Kampin stërvitor këtë javë nga shtete të ndryshme", ka shkruar Kuka në "Facebook".

Gattuso dënon Dajakun

Futbollisti i Hajdukut, Leon Dajaku, është dënuar për reagimin e tij pas largimit nga loja në xhiron e fundit të kampionatit kroat. Trajneri i klubit të Hajduk Splitit, Gennaro Gattuso, siç raportohet nga mediumi "Index Hr", ka

urdhëruar që Dajaku ta paguajë darkën për të gjithë ekipin në mbledhjen e radhës për ta shlyer aktin e tij. Pas largimit nga loja në ndeshjen ndaj Slavenit në minutën e 57 me epërsi 0:2, Dajaku i inatosur mori një shishe me ujë dhe e hodhi në stol. E

kapën edhe kamerat televizive. Sulmuesi nga Kosova është dashur të flasë me trajnerin e Hajdukut. Gattuso shpjegoi se ai nuk ishte vërtet i nervozuar me të, por me veten dhe disa nga gabimet dhe lëshimet e tij në lojë.

Xavi shihet si zëvendësues i Ten Hagenit

Pozita e Erik Ten Hagut është ende në dyshim të fortë pavarësisht prej fitores kundër Brentfordit. Në Angli mediet vijojnë të flasin për këtë temë, madje "Daily Mail" shkon edhe më tej duke zbuluar se një prej kandidatëve për ta marrin stolin

e Manchester Unitedit është edhe Xavi. Sipas së përditshmes britanike, nëse Ten Hag shkarkohet, Xavi është opsioni i parë ta marrë drejtimin e "djavës të kuqe". "Daily Mail" shton se Xavi është takuar me drejtuesit e Manchester Unitedit.

Interi pritët ta rivalizojë Juven për Ismajlin

Ardian Ismajli është një nga lojtarët e momentit në Serinë A, ndërsa për shërbimet e tij ka hyrë në garë edhe një klub tjetër i madh italian. Mediet në Apenine

shkruajnë se, përveç Juventusit, tashmë edhe Interi mund të konkurrojë për kartonin e mbrojtësit të kombëtares shqiptare. Ismajli u paraqit mirë

edhe ndaj Napolit, duke përballuar sfidën me sulmuesin Romelu Lukaku, dueli i suksesshëm ndaj belgut erdhi pas atyre ndaj Dushan Vlahoviçit të Juventusit dhe Artjom

Dovbik të Romës. Padyshim që 28-vjeçari ka qenë tepër i fortë edhe me kuqezinjët duke shënuar edhe gol në fitoren 2-1 në Pragë ndaj Ukrainës në Ligën e Kombeve.

Kartoni i tij kushton 5 milionë euro, pak për standardin e Serisë A, ndërsa për mbrojtësin është një kulm që ai e arriti pikërisht pak ditë më parë, më 18 tetor.

Verstappenin replikon me Norrisin: Duetet zgjidhen në pistë

MILTON KEYNES, 23 TETOR - Incidenti disa xhiro nga fundi në garën e Amerikës mes britanikut Lando Norris (McLaren) dhe holandezit Max Verstappen (Red Bull) duket se do të zgjasë edhe pak ditë derisa të zhvillohet këtë fundjavë gara e radhës, ajo në

Meksikë. Pas akuzave të Norrisit së penalizimi me 5 sekonda ishte i padrejtë dhe i njëanshëm, ka ardhur replika e holandezit. "Nuk kam shtyrë askënd jashtë piste", komentoi lideri aktual i kampionatit botëror. "Nuk e prekëm njëri-tjetrin. U përpoqa ta merrja

këndin, isha 'full lock' me timonin. Është një garë e Formulës 1. Këtu nuk jemi në kopsht fëmijësh që të qahemi. Gjërat zgjidhen në pistë", ka thënë më tej Verstappen. "Ishte një hapësirë brenda dhe unë shkova atje. Ajo kthesë është shumë e gjerë, kështu që jua jep

mundësinë të shkoni shumë gjerë ose të përpiqeni të qëndroni shumë ngushtë. Zgjedha këtë opsion dhe isha ende aty. Ai parakalim nga jashtë ishte i gabuar, pasi përfitoi Norrisi. Parakalimi duhet të ndodhte në pistë", u shpreh kampioni i botës në Formula 1.



Vinicius Jr: Dua ta fitoj 'Topin e Artë' për të gjithë brazilianët

MADRID, 23 TETOR - Vinicius Jr. ishte protagonist absolut në Ligën e Kampionëve. Sulmuesi brazilian shënoi një "hat-trick" në fitoren 5-2 të Real Madridit ndaj Borussia Dortmundit në kompeticionin më të lartë evropian për klubet. Pas ndeshjes u shpreh: "Ndihehem shumë i lumtur që jam në gjendje ta kthej gjithë dashurinë e treguar nga kjo skuadër, nga presidenti dhe të gjithë njerëzit që besuan në mua kur isha vetëm 16-vjeçar. Kur isha në Rio de Zhaneiro dhe te Flamengo, drejtuesit e këtij klubi të madh bënë gjithçka që ishte e mundur për të më sjellë këtu. Në fakt ishte një proces shumë i gjatë. Deri në ndeshjen e sotme, ku shënova 'hat-trick'-un e parë në Ligën e Kampionëve, u rrita çdo ndeshje. Jam vetëm 24-vjeçar dhe kam arritur të mësoj nga futbollistët më të mirë, por edhe nga drejtuesit



më të mirë. Dua të vazhdoj të rritem, sepse luaj me më të mirët në botë. Dua të bëj histori si Marcelo, Casemiro, Roberto Carlos, Ronaldo". Disa fjalë pati edhe për "Topin e Artë" 2024: "Tifozët e Brazilit dhe në mbarë botën janë

gjithmonë të rëndësishëm. Ata më kanë mbështetur gjithmonë, që kur kam ardhur këtu në moshën 18-vjeçare. Gjithmonë kam thënë se doja ta fitoja këtë çmim për të gjithë brazilianët. Shpresoj që të hënën të ndodhë kështu".

SHKURT

Ancelotti: Vinicius e meriton 'Topin e Artë'

Real Madridi e përmbysi rezultatin në ndeshjen ndaj Borussia Dortmundit duke fituar me rezultat 5-2. Vinicius Junior realizoi tri gola duke qenë lojtari më i mirë në ndeshje. Trajneri Carlo Ancelotti ka thënë se futbollisti brazilian e meriton "Topin e Artë". "Është e pabesueshme që një lojtar të ketë një pjesë të dytë si ai. Unë mendoj se Vinicius do ta fitojë 'Topin e Artë' jo për golat që realizoi këtë mbrëmje, por për atë që bëri sezonin e fundit", ka thënë Ancelotti.

Rodrygo mungon në 'El Clasico'

Skuadra e Real Madridit gjatë fundjavës do të luajë ndaj Barcelonës, në ndeshjen e vlefshme për La Liga. Rodrygo, sulmuesi i Kombëtares së Brazilit, do të mungojë në këtë takim mjaft të rëndësishëm e të shumëpritur nga të gjithë, për shkak se sulmuesi brazilian u lëndua mbrëmë gjatë ndeshjes ndaj Borussia Dortmundit, në Ligën e Kampionëve. Ndeshja në mes të Real Madridit dhe Barcelonës do të zhvillohet të shtunën në orën 21:00 në "Santiago Bernabeu".

Xavi është në listën e Unitedit

Pozita e Erik Ten Hag është ende në dyshim të fortë pavarësisht prej fitores kundër Brentfordit. Në Angli mediet vijojnë të flasin për këtë temë, madje "Daily Mail" shkon edhe më tej duke zbuluar se një prej kandidatëve për të marrë stolin e Manchester Unitedit është edhe Xavi. Sipas së përditshmes britanike, nëse Ten Hag shkarkohet, Xavi është opsioni i parë për ta marrë drejtimin e "djajve të kuq". "Daily Mail" shton se Xavi është takuar me drejtuesit e Manchester Unitedit.

Objektivi i Realit dhe Barçës, Davies kërkon bonus prej 15 milionë eurosh

Objektivi i Real Madridit dhe Barcelonës, Alphonso Davies, ka kërkuar një bonus nënshkrimi prej 15 milionë eurosh nga blerësit e mundshëm, sipas "SPORT". Kontrata e kanadezit me Bayern Munchenin do të përfundojë në verën e vitit 2025 dhe ai duket se do të largohet me kosto zero. Si Barça ashtu edhe Reali raportohet se janë të vetëdijshëm për kushtet që Davies ka vendosur dhe do të jetë interesante të shihet nëse ata do të vazhdojnë ta ndjekin. Mbrojtësi i majtë mund të nënshkruajë një parakontratë në janar 2025. Mbetet për t'u parë nëse Barcelona ose Real Madridi do t'i afrohen atij në merkaton e janarit. Kanadezi ka bërë 204 paraqitje në të gjitha kompeticionet për Bayernin, duke shënuar 11 gola dhe duke dhënë 32 asiste në total. Në nivel ndërkombëtar, ai ka luajtur 55 herë me Kanadanë, duke shënuar 15 gola.

Bostoni dhe lakersat e nisin me fitore, LeBron Jamesi me të birin në fushë

LOS ANXELOS, 23 TETOR - Pas një pritjeje të gjatë, NBA fillon sërish dhe, si zakonisht, inaugurohet nga kampionët në fuqi: në Boston, me Celticsin që e nisi sezonin e rregullt në mënyrën më të mirë të mundshme teksa mposhtën Knicksin 132-109, ku protagonist ishte i përhershmi Jason Tatum me një double double (37 pikë dhe 10 asistime). Vendasit krijuan menjëherë shkëputjen ndaj kundërshtarit teksa pas përfundimit të dy periodave të para e panë veten në avantazh +19 pikë. Derrick White me 24 pikë si dhe Jaylen Brown me 23 ishin përcaktues në fitoren e parë sezonale për ekipin e Mazzullës, ndërkohë që 22 pikët e realizuara nga Brunson rezultuan të pamjaftueshme për Nicksin. Në ndeshjen tjetër të natës hapëse, Los Angeles Lakersi mundi Minnesota Timberwolvesin 110-103 falë 36 pikëve dhe 16 reboundeve të Anthony Davisit. LeBron Jamesi



realizoi 16 pikë, ndërkohë që vlen për t'u përmendur fakti se në këtë ndeshje u aktivizua për rreth 3 minuta edhe i biri i tij Bronny, duke hyrë në historinë e NBA-s si lojtarët e parë babë e bir që aktivizohen bashkërisht në një ndeshje të basketbollit amerikan, pasi më herët ata e kishin bërë diçka të tillë, në ndeshjet e Pre Seasonit. Sfidat

ishte e balancuar teksa dallimin që kreu Lakersi në periodën e dytë, thujse u balancua nga Timberwolvesi, që në një moment të garës e çoi dallimin në -4 pikë, por që u tregua jo në lartësinë e duhur më pas për ta përballuar kalifornianën, që e nisi sezonin në mënyrën më të mirë të mundshme.

Fonseca: Ndeshje pa intensitet, Leao duhet të punojë për ekipin

Trajneri i Milanit, Paulo Fonseca, ka folur për "Sky" pas suksesit 3-1 ndaj Club Brugge në ndeshjen e vlefshme për raundin e tretë të Ligës së Kampionëve. "Luajtëm një ndeshje pa

intensitet, shumë ngadalë. Jo mirë kundër një ekipi me mbrojtje të ulët. Kur hynë Okafor dhe Chukwueze, ndeshja ndryshoi dhe ata sollën energji. Pas golit të dytë bëmë gjëra shumë të

mira", ka thënë Fonseca. "Camarda? Ai dhe skuadra e kishin merituar këtë moment. Do të ishte një moment shumë i bukur, por të konsiderohej goli i rregullt. Një i ri që e meriton të jetë në

grup dhe që ka punuar shumë për të qenë këtu. Ai do të shënojë shumë gola në të ardhmen. Është vetëm fillimi", ka deklaruar Fonseca, i cili foli edhe për zëvendësimin e Leaos: "Nuk

ka asnjë problem specifik me Leao, asnjë ndëshkim. Më duheshin Okafor dhe Chuku. Rafa, gjithashtu, duhet ta kuptojë këtë dhe të punojë për ta ndihmuar ekipin si të gjithë lojtarët".

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionale Kompanija za Uključanje Otvore
"PASTRIMI" s.h.a. d.d.
Nr. 6379 dt. 23.10.2024
Prishtinë - Pristina



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8 Udhëzimin Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik konkretisht Neni 5 Paragrafi 1,2 dhe Neni 7, Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, Vendimin e datës 23.10.2024 me numër të protokollit 6304 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK (Për plotësimin e vendit të punës)

Titulli i vendit të Punës: "Inxhinier i Makinerisë (Mekanikës)" në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë.

Departamenti: Kabineti i Kryeshefit

Numri i Referencës: KKE/KJ-19/2024

Koeficienti/Paga mujore: Niveli V

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar,

Periudha Provoese: 3 muaj

1. Detvat dhe Përgjegjësitë:

- Dizajnimi dhe projektimi i Instalimeve të Makinerisë për projektet e zhvilluara nga kompania;
- Analize e Plotë për fazën e Instalimeve të Makinerisë për nevojat e kompanisë – Rekomandime profesionale lidhur me projektet e punuara nga kompanitë projektuese për nevojat e kompanisë;
- Punët tjera lidhur me makinerite duke përfshirë dhënie e njohurive profesionale për menaxhmentin, përmirësimin e projekteve ekzistuese, pjesëmarrjen në implementimin e projekteve të kompanisë, etj.
- Organizimi/Mbështetje në punët dhe dhënie e instruksioneve për kontraktorët e kompanisë dhe mbikëqyrjen e realizimit të punëve nga ana e tyre konform planifikimit dhe organizimit të punëve dhe caktimit të prioriteteve;
- Planifikimin e kryerjes së punëve, angazhimin e resurseve dhe mbikëqyrjen e punës.
- Informimin e udhëheqësve për mbarëvajtjen e punëve, në pajtueshmëri me nevojat dhe kërkesat në vend-punim.
- Mbajtjen e saktë dhe të rregullt të shënimeve dhe raporteve mbi punët e kryera dhe ato të planifikuara dhe raportimin e rregullt të punëve tek udhëheqësit e kompanisë.
- Pranimin e detyrave nga Kryeshefi apo i autorizuari i tij dhe implementimin e tyre
- Detyrat tjera të përcaktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv.
- Për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- ✓ Të zotërojë të paktën njëri nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë Universitare në fushën përkatëse
- ✓ **Përvoja e punës e kërkuar:** 3 vite përvoja punë profesionale

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- ✓ Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati,
- ✓ Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore,
- ✓ Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës),
- ✓ Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve,
- ✓ Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, (E dëshirueshme).
- ✓ Kopje të Letërnjoftimit,
- ✓ Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale jo më të vjetër se 3 muaj.

6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyret e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.
Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike; punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. Data dhe ora e saktë e përmbvilljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 24.10.2024 deri me datën 07.11.2024. Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim (testi me gojë).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë,
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë,
- ✓ Intervista (testi me goje) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik dhe individualisht.

10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Konkursi Publik i hapur deri me datën 07.11.2024.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri 7 ditë,

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Zigur Hajdari shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Miftar Gashi shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Rijad Vejapi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjumnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjumnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

Kompania Rajonale e Mbeturimave
Regionale Kompanije za Uklarjanje Qteada
"PASTRIMI" sh.a d.d.
Nr.br. 6379 dt. 23.10.2024
Prishtine - Pristina



REGIONALNO PREDUZEÇE ZA OTPAD "PASTRIMI" SH. A

Na osnovu Zakona br. 03/L-212 o radu, člana 8. Administrativne instrukcije FPT br. 01/2024 o uređenju konkursnih postupaka u javnom sektoru, posebno člana 5. stav 1,2 i člana 7. Uredbe br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RM "Čišćenje" SH. A, Odluka od 23.10.2024. godine sa brojem protokola 6304 glavnog izvršnog direktora RM "Pastrimi" SH. A onda, proglasite ga:

JAVNI KONKURS Za popunjavanje radnog mesta

Naziv posla: "Mašinski inženjer" u KRM "Pastrimi" SH. (1) pozicija;

Odeljenje: Kabinet izvršnog direktora

Referentni broj: KKE/KJ-19/2024

Mesečni koeficijent/plata: Nivo V;

Trajanje ugovora: Bez fiksnog vremena;

Probni period: 3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- Projektovanje i projektovanje mašinskih instalacija za projekte koje je razvila kompanija;
- Kompletna analiza faze mašinskih instalacija za potrebe preduzeća – Stručne preporuke u vezi sa projektima koje projektne kompanije rade za potrebe preduzeća;
- Ostali poslovi vezani za mašine, uključujući pružanje stručnog znanja menadžmenta, poboljšanje postojećih projekata, učešće u implementaciji projekata kompanije, itd.
- organizovanje/podrška u izvođenju radova i davanje instrukcija izvođačima radova preduzeća i nadzor nad realizacijom radova od strane njih u skladu sa planiranjem i organizacijom radova i određivanjem prioriteta;
- Planiranje za obavljanje posla, angažovanje resursa i nadzor nad radom.
- Informisanje lidera o dobrobiti radova, u skladu sa potrebama i zahtevima u zemlji.
- Vođenje tačne i redovne evidencije i izveštaja o obavljenim i planiranim zadacima i redovno izveštavanje o poslovima rukovodiocima kompanija.
- Prihvatanje dužnosti od strane izvršnog direktora ili njegovog ovlašćenja i njihovo sprovođenje;
- Ostale dužnosti koje je odredio izvršni direktor.
- On je odgovoran izvršnom direktoru za svoj rad.

2. Opšti kriterijumi za prijem na dužnost:

- ✓ Da bude državljanin Republike Kosovo,
- ✓ Da imaju punu sposobnost da deluju, u skladu sa važećim zakonima;
- ✓ Da poseduje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da izvrši odgovarajući zadatak;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- ✓ Uspešno proći procedure prijema utvrđene u ovom zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi

- ✓ **Potrebno obrazovanje:** Visoka stručna sprema u odgovarajućoj oblasti;
- ✓ **Potrebno radno iskustvo:** 3 godine profesionalnog iskustva.

4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Sposobnost logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ istraživanje, analitika, evaluacija i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- ✓ sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i ostvarivanja diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- ✓ Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i način njihovog podnošenja

- ✓ Aplikacija popunjena i potpisana od strane kandidata,
- ✓ Kopija diploma koje su izdale obrazovne institucije,
- ✓ Kopija potvrde o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu),
- ✓ Dokazi o obukama i kursovima;
- ✓ Kopija procene rada za poslednje dve godine, (poželjno);
- ✓ Kopije lične karte;
- ✓ Dokaz da nije osuđen za krivično delo ne starije od 3 meseca.

6. Način prijavljivanja na konkurs:

Zainteresovani kandidati, zvanični obrazac se može dobiti u kancelarijama za ljudske resurse u RM "Pastrimi" SH.A.
Sve prijave moraju biti podnete elektronskim putem samo putem elektronske platforme;
punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. tačan datum i vreme završetka javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 24.10.2024. do 07.11.2024. godine. Poslednji put prijema aplikacija je 4 posle podne.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Način vrednovanja i kriterijumi vrednovanja:

Evaluacija kandidata vrši se na osnovu CV-a, pismenog i intervjuškog testa (usmeni test).

- ✓ CV kandidata je ocenjen do deset (10) bodova,
- ✓ Pismeni test se vrednuje do sedamdeset (70) bodova,
- ✓ Intervju (usmeni test) se procenjuje na dvadeset (20) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaz ostvaren najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima:

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan raspored postupka zapošljavanja:

Javni konkurs otvoren do 07.11.2024.

Preliminarna faza verifikacije prijava do 7 dana,

Faza pismenog testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervju do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervju.

Napomena: Nesastavljeni, neskenirani dokumenti i oni koji stignu nakon isteka roka za konkurs neće biti pregledani.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

